



ÅSTORP



Jeni objekt **dhune**,
kërcënimi apo **mbikëqyrje**
nga familja juaj, partneri
apo të afërmit e tu?

Ju mund të kërkoni ndihmë!

PËR JU QË JENI OBJEKT DHUNE:

Kërko ndihmë duke kontaktuar Kujdestarinë për gra, Shërbimin social, Qendrën mjekësore, mësuesin tuaj apo dike tjetër që ju i besoni dhe që ai mund t'ju ndihmojë për kontakte të para.

Ha fëljande saker tillgängliga om du skulle behöva fly akut:

Para, telefon, kartelë banke, le-tërnyoftim ose pasaportë, çelësa, rrobe, ilaçe të rëndësishme, gjera tjera të rëndësishme.

Për fëmijë: lodra favorite, rrobe, shishe ushqyese, qumështin, pelena.

Do të ishte mirë: te kesh të dhënat kontaktuese të ndonjë miku që do t'ju ndihmonte në ndonjë rast akut.

KËSHILLA DHE PËRKRAHJE

Nëse ke nevojë të bisedosh me dikë për dhunën atëherë mund të kontaktosh Kujdestarinë për gra ose Qendrën mjekësore.

Nëse dëshironi t'i bashkëngjitni ndonjë grupi që ka përjetuar situata të njëjta mund të kontaktoni Shërbimin social. Shërbimi

social ju informon lidhur me ndihmën që mund të merrni më tutje.

EKONOMI

Kontakto Shërbimin social në qoftë se keni pyetje lidhur me ekonominë.

NËSE LËNDOHESH

Kontakto Qendrën mjekësore ose pranimin emergjent në spital për t'u mjekuar dhe për të dokumentuar lëndimet tuaja. Dokumentimi është më rëndësia të madhe nëse mendoni ndonjëherë të paraqitni në polici dhunën.

KE NEVOJË PËR MBROJTJE

Kontakto Shërbimin social që vlerëson rrezikun dhe nevojën për mbrojtje. Sipas këtij vlerësimi mundet pastaj t'ju lejohet një banim i mbrojtur. Të dhëna të mbrojtura mund të kërkosh në Skatteverket kurse në Polici kërkon mes tjerash edhe telefon alarmues, gps dhe alarm akustik.

TË PARAQITESH RASTIN NË POLICI

Në qoftë se je rrahur apo kërcënuar nga dikush atëherë ju jeni ekspozuar dhunës. Paraqite rastin duke telefonuar policinë apo duke shkuar vet në stacionin më të afërm policor. Nëse dëshiron përkrahje gjatë hetimit në polici apo gjyq mund të merrni një ndihmë paditës nga policia. Nga kujdestaria e viktimave të dhunës ju mund të merrni informacion se si shkon paraqitja në polici, hetuesi e gjyq, gjithashtu mund të merrni përkrahje personale në hetuesi- polici dhe vet procesin gjyqësor.

Para një paraqitjeje eventuale në polici në të ardhmen

Për ditat. Është lehtë të harrosh çka ndodhi dhe kur ndodhi. Fotografo lëndimet eventuale. Mos i laj rrobat pas dhunës eventuale. Ruaj e- meilet eventuale apo sms-at. Kërko ndihmën e mjekut që ai të dokumentojë plagët e mundshme.

PËR FËMIJËT QË JANË DËSHMITARË TË DHUNËS:

Fëmijët që kanë përjetuar dhunë ndërmjet të afërmeve të tyre të rritur kanë nevojë për përkrahje për t'ua shpjeguar atë që ka ndodhur. Në Pollux të Shërbimit mjekësor të hapur fëmijët mund të flasin për atë që ka ndodhur në të ashtuquajturat biseda personale. Ka mundësi gjithashtu të marrin pjesë në grupe veprues në të cilat mund të takojnë fëmijë tjerë që kanë situata të njëjta. Këtë mund ta kërkojnë në Shërbimin social.

Pyetje rreth përkujdesjes së fëmijës, banimit dhe vajtje -ardhjeve

Dëshiron të dish të drejtat tua si prind? E Drejta Familjare e Shërbimit Social u jep këshilla dhe shqyrton pyetjet rreth përkujdesjes, banimit dhe vajtje-ardhjeve.

PËR JU QË USHTRONI DHUNË:

Që të mos përdorni dhunën mund t'ju ndihmoi kuratori i Qendrës medicinale me biseda të ndara ose duke kërkuar kontakte me grupe vepruese përmes Shërbimit Sociale.

Përkrahje tjetër/ informacion

www.kvinnofridslinjen.se (Për të cenuara, ushtrues dhune, të afërm)

020-505050

www.terrafem.org (Telefoni kujdestar në gjuhë tjera) 020 52 10 10

www.tuvaforum.se (Informacion, këshilla dhe përkrahje)

Shiko gjithashtu

www.astorp.se/valdinararelation

Të dhëna kontaktuese:

Socialtjänsten,

Medborgarkontoret Åstorps kommun

Storgatan 7, Åstorp

042- 643 00 ose 640 00 (qendër lidhjeje)

(trego se është fjala për dhunë në familje, fëmijë ose të rritur)

Socialjour

(për ndihmë akute kur Shërbimi Social është i mbyllur)

Telefoni: 114 14 (Qendra e lidhjes së

Policisë, kërko kujdestari sociale)

Policia

Berga allé 25, Helsingborg. Telefoni: 114 14

Pollux

(Dhënie këshillash e drejtë familjare, biseda përkrahëse për fëmijë dhe prindër)

Torggatan 19 A, Åstorp

042-574 75

Kvinnojourer

(banim, biseda përkrahëse për të cenuar dhe të afërm)

Helsingborg 042-18 15 10

Ängelholm 0431- 102 96

Höganäs 042- 34 02 07

Brottsofferjour:

Ängelholm 0431- 143 00

**ÅSTORP**